

DËMI EKZISTENCIAL

MA. Herjeta DELIAJ*

Floralba MITRUSHI*

Abstrakt: *Dëmi ekzistencial është konfiguruar së fundmi nga doktrina dhe praktika gjyqësore si një figurë autonome dëmi, në kategorinë e dëmit jopasuror. Shfaqja e kësaj figure të posaçme është fryt i evolucionit dhe dimensioneve të reja që ka fituar kategoria e dëmit jopasuror për shkak të emancipimit të konceptit “njeriu-vlerë”. Dëmi ekzistencial shkakton ndryshime në rrjedhën normale të jetës së të dëmtuarit të cilat ndikojnë negativisht në personalitetin e tij.*

Dëmi ekzistencial është dëmi i shkaktuar nga fakti i paligjshëm që cënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thujtë në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit etj. Dëmi ekzistencial, është objektivisht i vërtetueshëm dhe sjell cënime me natyrë subjektive dhe të lidhura ngushtë me personin e të dëmtuarit.

Dëmi ekzistencial ka ngjallur debate të mprehta nëse është një figurë e posaçme dëmi apo në të vërtetë është i integruar në figurën e dëmit moral, jemi të mendimit se dëmi ekzistencial përbën një figurë të pavarur në kategorinë e dëmit jopasuror duke zmadhuar përmasat e këtij lloji dëmi.

Fjalët çelës: *Dëmi ekzistencial, dëmi jopasuror, dëmi moral, emancipimi i konceptit njeriu-vlerë, prezumimi i dëmit.*

1. Hyrje

Për një kohë relativisht të gjatë dëmi jopasuror është evidentuar vetëm me dëmin moral. Por, gjatë njëzet viteve të fundit, fillimisht doktrina dhe pastaj praktika gjyqësore, ka evidentuar dy figura të reja të dëmit jopasuror. Nëpërmjet vendimit të vitit 1986 të Gjykatës Kushtetuese Italiane fitoi kuptim të ri *dëmi ndaj shëndetit ose dëmi biologjik*, ndërsa, nëpërmjet vendimit unifikues të vitit 2006 të Gjykatës së Kasacionit, në Itali, u pranua *dëmi ekzistencial* si një figurë e posaçme e dëmit jopasuror. Në vendin tonë, vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 12, dt. 13 dhe 14 shtator 2007, i dha përmasa të reja kategorisë së dëmit jopasuror duke vënë përkrah figurës së dëmit moral, (natyra jopasurore e të cilit ishte e konsoliduar) edhe figurën e dëmit ekzistencial dhe dëmit biologjik. Dispozita e nenit 625 të K. Civil të RSH është

* Jurist, Departamenti Juridik “2K Group”sh.p.k.

* Jurist, Departamenti Juridik “ABISSNET”sh.a.

interpretuar e zbatuar ne pajtim dhe harmoni me parimet themelore kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh dhe reflektuar edhe vetë procesin dinamik të ndërgjegjësimit e të emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sikurse është trajtuar më sipër në këtë vendim, sipas neneve 3, 15 e vijues të Kushtetutës, parashikohet mbrojtje *e posaçme dhe e barabartë* e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut. Në këtë kuptim, edhe neni 608 e vijues i K. Civil synojnë riparimin e plotë të *çdo dëmi* të pësuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm në pasurinë në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që mëshirojnë *vlerat e vetë njeriut*.

Pra, nëpërmjet këtij vendimi është pranuar që në kategorinë e dëmit jopasuror parashikuar në nenin 625 të K.C përfshihen tre figura:

- figura e dëmit moral;
- figura e dëmit biologjik;
- figura e dëmit ekzistencial.

Në këtë artikull do të përqendrohemi në shpjegimin e kuptimit të dëmit ekzistencial dhe të disa elementëve që lidhen me këtë koncept.

2. Kuptimi i dëmit ekzistencial

Dëmi ekzistencial është konfiguruar së fundmi nga doktrina dhe praktika gjyqësore¹ si një figurë autonome dëmi në kategorinë e dëmit jopasuror. Shfaqja e kësaj figure të posaçme është fryt i evolucionit dhe dimensioneve të reja që ka fituar kategoria e dëmit jopasuror për shkak të emancipimit të konceptit "*njeriu-vlerë*". P.sh: Gjykata e Apelit në Milano i ka mëshuar rëndësisë së dëmit ekzistencial si mbrojtje apo garanci që ofron e Drejta për cilësinë normale të jetës dhe shfaqjen e lirë të personalitetit të të dëmtuarit.² Dëmi ekzistencial shkakton pasoja të ndryshme nga dëmi moral dhe biologjik.³ Dëmi ekzistencial shkakton pasoja të tilla që nuk lidhen me vlerat ekonomike, por me marrëdhëniet shoqërore, familjare dhe prindërore, dëmton aftësitë kreative, sportive, kulturore, artistike të personit të dëmtuar, dëmton aftësinë e tij për të punuar etj. P.sh: Humbja e fetusit për shkak të pakujdesisë mjekësore konsiderohet dëmtim për shkak të të cilit mund të kërkohet shpërblimi i dëmit ekzistencial.⁴ Vlen të përmendet vendimi Nr. 7713 i vitit 2000 të Gjykatës së Kasacionit Italiane që bazohej në rekursin që kishte bërë

¹ Vendimi nr. 6572 dt. 24.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit Italiane, Vendimi i datës 14.02.2003 i Gjykatës së Apelit Milano, Vendimi nr.12, Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Shqipëri.

² Gjykata e Apelit Milano, Seksioni 2 Civil, 14 shkurt 2003.

³ Lima F."Il danno esistenziale", 7.02.2007.

⁴ Vendimi i Gjykatës së Kasacionit Italiane, nr. 2677, dt. 11.03.1998.

një prind për të mospaguar ndaj fëmijës pensionin e përmuajshëm. Ankuesi mbështeste pretendimin e tij në faktin se fëmija nuk e kishte të nevojshme marrjen e këtij pensioni për shkak se mbahej në gjendje shumë të mirë nga nëna natyrale. Gjykata arriti në konkluzionin se sjellja e babait shfaqur nëpërmjet mosveprimeve neglizhente kishte shkaktuar një dëm në të drejtat e fëmijës, në cilësinë e birit dhe të të miturit. Gjykata konstatoi se ushtrimi i detyrimeve prindërore ndikon në rritjen e shëndoshë dhe të ekuilibruar të fëmijës, në mënyrë që të integrohet lehtësisht në marrëdhëniet shoqërore. Neglizhenca në sjelljen e prindërve është shkak për dëmin ekzistencial.

Dëmi ekzistencial shkakton ndryshime në rrjedhën normale të jetës së të dëmtuarit të cilat ndikojnë negativisht në personalitetin e tij dhe në veprimtarinë e përditshme duke nxitur në këtë mënyrë një gjendje jo të mirë shëndetësore dhe shpirtërore prej së cilës prodhohet ankth, irritime, depresion, vështirësi për përbalimin e situatave jetësore etj. Në këtë rast, objekti i dëmshpërblimit është humbja ose privimi nga veprimtaria realizuese, prodhuese e të të dëmtuarit.⁵ Por, **Vendimi nr. 6572 dt. 24.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Kasacionit Italiane** i dha dimensione të reja figurës së dëmit ekzistencial. Sipas këtij vendimi, dëmi ekzistencial përfshin *“çdo dëmtim që shkakton ndryshime tronditëse në mënyrën e të jetuarit të të dëmtuarit duke ja shmangur mundësitë për të shfaqur personalitetin e tij në marrëdhëniet shoqërore ose “në botën e jashtme”*. Dëmi ekzistencial sipas gjykatës, nuk i referohet dimensionit të brendshëm, emotiv të të dëmtuarit. Për shkak të dëmit të pësuar, i dëmtuari bën zgjedhje që kanë të bëjnë me jetën e tij, të ndryshme nga ato që do të bënte në qoftë se nuk do të shkaktonte dëmi.

Në Shqipëri, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007, nr. 12 për herë të parë integroi në jurisprudencën shqiptare figurën e dëmit ekzistencial që njihet pak ose aspak në radhët e gjyqtarëve apo juristëve të tjerë. Nëpërmjet këtij vendimi evidentohet qartazi përprjekja e Gjykatës së Lartë për të konfiguruar dëmin ekzistencial si figurë të posaçme dëmi, duke aprovuar në këtë mënyrë jurisprudencën e huaj në favorizimin e ekzistencës së dëmit ekzistencial dhe shpërblimit të tij. Kuptimi i dëmit ekzistencial shpjegohet në mënyrë të detajuar nga gjykata. Sipas vendimit unifikues të sipërpërmendur, dëmi ekzistencial *është dëmi i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thujtë në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizonin pozitivisht qenien e tij apo mund ta karakterizonin pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të*

⁵ Gjykata e Apelit Milano, Seksioni 2 Civil, 14 shkurt 2003.

ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm.

Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i hapi rrugë gjykatave të niveleve më të ulta të njohin figurën e dëmit ekzistencial. Ky vendim, në pjesën e pranimin të dëmit ekzistencial shënon një avancim për t'u vlerësuar të Gjykatës së Lartë, duke qenë se një koncept i tillë u përafua në jurisprudencën shqiptare në një periudhë që akoma ende një farë ngatërrimi në gjykatat tona në lidhje me nocionin e dëmit jopasuror. Kështu, gjykatat e niveleve më të ulta në çështjet gjyqësore që ju paraqiten për zgjidhje, rast pas rasti, kanë detyrën që të zbërthejnë kuptimin e këtij dëmi dhe të evidentojnë ekzistencën e tij.

3. Analizë për kushtet e domosdoshëm për të vërtetuar dëmin ekzistencial

Në nenin 608 të Kodit Civil parashikohet që:

“Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin dhe pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”

Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.

Ndërsa, në nenin 609 parashikohet që:

“ Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.”

Nga interpretimi i këtyre dispozitave që të lindë detyrimi i dëmtuesit për shpërblimin e dëmit jopasuror duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative këto kushte:

1. Fakti i paligjshëm;
2. Ekzistenca e dëmit;
3. Faji;
4. Lidhja shkakësore.

Meqenëse dëmi ekzistencial përfshihet në kategorinë e dëmit jopasuror si një figurë e posaçme e tij, atëherë kushtet e lartpërmendura duhen të përmbushen edhe për dëmin ekzistencial.

3.1 Fakti i paligjshëm

Fakti i paligjshëm nënkupton veprimin ose mosveprimin që është kryer në kundërshtim me rendin juridik ose zakonet e mira, prej të cilit është shkaktuar dëmi. Kjo rrjedh nga neni 608 sipas të cilit “*Personi që në mënyrë të paligjshme...*” apo “*Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.*”

Fakti i paligjshëm shprehet në kryerjen e një veprimi ose mosveprimi që bie ndesh me rendin juridik ose me zakonet e mira. (Nuk janë të pakta rastet kur dëmi mund të shkaktohet edhe si rezultat i mosveprimeve. P.Sh: Gj. Italiane e Kasacionit me vendimin Nr. 7713 të vitit 2000 arriti në konkluzionin se sjellja e babait shfaqur nëpërmjet mosveprimeve neglizhente kishte shkaktuar një dëm ekzistencial në të drejtat e fëmijës së mitur.) Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm është një sjellje e vullnetshme dhe e vetëdijshme e personit. Paligjshmëria është një kategori objektive. Padijenja e një personi për njohjen e ligjeve nuk e përjashton atë nga përgjegjësia civile.⁶ Kodi ynë Civil ka parashikuar *shkeljen ose cënimin e interesave dhe të drejtave që mbrohen nga rendi juridik⁷ ose nga zakonet e mira* duke mos kufizuar në këtë mënyrë përgjegjësinë civile vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

3.2 Ekzistenca e dëmit

Që një person që ka kryer faktin e paligjshëm të mbajë përgjegjësi civile, duhet që domosdoshmërisht të jetë shkaktuar dëmi jopasuror në formën e dëmit moral, biologjik apo ekzistencial. Tre figurat e dëmit jopasuror mund të ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, ose në mënyrë kumulative dhe nga secili prej tyre mund të derivojë e drejta e të dëmtuarit për të kërkuar dëmshpërblimin përkatës. Por, në raste të tilla gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të evituar rastet e dëmshpërblimeve të dyfishta.⁸ Për të evituar dhënien e dëmshpërblimeve arbitrare duhen përcaktuar parametra matës të tillë të cilët t’i referohen:

- personalitetit të të dëmtuarit;
- interesit të cënuar;
- veprimtarisë së kryer prej të të dëmtuarit;
- ndikimit të veprimit ose mosveprimit të paligjshëm në personalitetin e të dëmtuarit;

⁶ Mariana Semini (Tutulani) “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” (pjesa e përgjithshme), Botimi i tretë, Tiranë 2002, faqja 226.

⁷ ‘Rendi juridik është, tërësia e marrëdhënieve të njerëzve në shoqëri që shprehen dhe sanksionohen në të drejtën, në normat juridike.’ Luan Omari “Parime dhe institucione të së drejtës publike” Shtëpia botuese Elena GJIKA, Tiranë 1999, faqe 193.

⁸ Gjykata e Apelit Milano, Seksioni 2 Civil, 14 shkurt 2003.

- ndryshimit të gjendjes së të dëmtuarit në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore.⁹

3.3 Faji

Neni 608 parashikon fajin si një ndër kushtet e nevojshëm për të pasur përgjegjësi civile për dëmin jopasuror. Faktikisht në të drejtën civile nuk janë dhënë definicione ligjore për fajin dhe format e tij. Në lidhje me të është bërë referencë në doktrinën dhe të drejtën penale. Në nenin 608/2 i K. Civil parashikohet që *“Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”* Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton që fajësia prezumohet. I takon dëmtuesit barra e provës të vërtetë që nuk ka faj, sepse dëmtuesi më mirë se kushdo tjetër është në gjendje të provojë se pavarësisht se sjellja e tij mund të ketë qenë e paligjshme ka qenë i ndodhur në rrethana të tilla të cilat i ka pasur të pamundur për t’i mënjeluar.

3.4 Lidhja shkakësore

Në nenin 609 parashikohet që *“ Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit”* duke sanksionuar në këtë mënyrë lidhjen shkakësore si një ndër kushtet që duhet të ekzistojë kumulativisht me tre të tjerat për përgjegjësinë civile për dëmin jopasuror. Lidhja shkakësore është një kategori objektive, që pasqyrohet në mendjen e personit se si ajo do të zhvillohet, por pavarësisht kësaj, nuk mund të ndahet nga ana subjektive, sepse personi që kryen një veprim ose mosveprim me vullnet dhe me vetëdije kupton se nga ky veprim ose mosveprim shkaktohen pasojat të dëmshme.¹⁰ Referuar dispozitës, lidhja shkakësore duhet të jetë e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë. Lidhja shkakësore është e drejtpërdrejt atëherë kur nuk vepron asnjë faktor tjetër nga kryerja e faktit të paligjshëm deri në shkaktimin e dëmit jopasuror. Lidhja shkakësore e menjëhershme nënkupton ardhjen e dëmit pa vonesë.

Në rast se dëmi është shkaktuar nga disa veprime apo mosveprime, atëherë do të përcaktohet nëpërmjet ekspertëve se cili ka qenë veprimi ose mosveprimi determinant në shkaktimin e dëmit. Gjykata e Apelit në Milano, Seksioni 2 Civil me vendimin e 14 shkurtit 2003 ka mohuar ekzistencën e lidhjes shkakësore midis faktit të paligjshëm dhe dëmit të pretenduar prej të dëmtuarës. E dëmtuara kishte tentuar të vetëvritej duke pirë ilaçe gjumi në sasi të tepruar, për shkak të dëmit që pretendonte se i ishte shkaktuar nga zhurmat irrituese të një fabrike që ishte ndërtuar afër banesës së saj. Gjykata nga shqyrtimi i rrethanave dhe provave të paraqitura arriti në përfundimin që dëmi shkaktuar të dëmtuarës mund të ishte pasojë e faktorëve të tjerë, por jo e zhurmës së ndërmarrjes,

⁹ Gjykata e Apelit Milano, Seksioni 2 Civil, 14 shkurt 2003.

¹⁰ Prof. Dr. Ismet Elezi, Prof.As.Dr. Skënder KAÇUPI, Dr. Maksim HAXHIA, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2001, faqja 102.

duke evidentuar në këtë mënyrë mungesën e lidhjes shkakësore. Në këtë rast, gjykata konstatoi vetëm dëm të shkaktuar në të drejtën për të gëzuar qetësinë familjare.

Sipas vendimit unifikues nr. 12 të Gjykatës së Lartë në Shqipëri, në zbatim të nenit 609 të K. Civil për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore *materiale* ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cenimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkatës, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore *juridike* ndërmjet tyre.

Ndërsa, me lidhjen shkakësore juridike vërtetohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe cenimeve konkrete të pësuar në të drejta dhe interesa të ligjshme, si të subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshëm, ashtu edhe të personave të tjerë që rezultojnë të dëmtuar si rrjedhojë e pasojave që pranohet se vijnë normalisht e zakonisht nga i njëjti fakt i paligjshëm, sipas parimeve të rregullshmërisë dhe eficiencës së lidhjes shkakësore (*id quod plerumque accidit*).

4. Shpërblimi i dëmit ekzistencial

Siç u shpreh edhe më lart, dëmi ekzistencial është shfaqje e jashtme e cënimit të interesave të ligjshme lidhur me cilësinë e jetës. Si rezultat, është objektivisht i vërtetueshëm dhe nuk mund të provohet vetëm me anë të prezumimeve të thjeshta.¹¹ Gjykata duhet të pranojë vetëm ato cenime konkrete të të drejtave të personalitetit për të cilat ka bërë kërkim dhe që pretendohen nga i dëmtuari si dëm ekzistencial i pësuar prej tij. Për caktimin e dëmshpërblimit të dëmit ekzistencial, gjykata çmon mbi rrethana që vërtetojnë ndryshim të dukshëm e të rëndësishëm përkeqësues të jetës së përditshme dhe impaktin aktual e të ardhshëm të këtyre ndryshimeve në interesat jopasurore dhe marrëdhëniet e të dëmtuarit me botën e jashtme.

Në rastin e dëmit ekzistencial të shkaktuar në veçanti nga vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit të të afërmit, për caktimin e masës së dëmshpërblimit ekzistencial, Gjykata e Lartë ka dhënë kritere konkrete që duhet të mbahen parasysh nga gjykatat e tjera, si më poshtë vijon:

- afërsia gjinore me të dëmtuarin apo viktimën;
- mosha e viktimës dhe e të dëmtuarit;
- përbërja dhe gjendja e bashkëjetesës në familje.

4.1 Barra e provës

Cila palë ka barrën e provës në një procedim gjyqësor me objekt shpërblimin e dëmit ekzistencial? Barra e provës për vërtetimin e dëmit është e paditësit. Pra, kjo palë duhet të

¹¹ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gj. Lartë Nr. 12, dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007.

vërtetojë me prova pozitive alterimin në kuptimin përkeqësues të ekuilibrit, të zakoneve të jetës dhe vetë ekzistencës së tij personale për shkak të faktit të paligjshëm (*Onus probandi incumbit actori*).¹²

Edhe nëpërmjet Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit Italiane është arritur në përfundimin se:

“ Dëmi ekzistencial është një dëm objektiv, prandaj përkeqësimi i mënyrës së jetesës duhet të provohet nga i dëmtuari dhe jo vetëm të prezumohet.” Kështu, sipas gjykatës duke u provuar dëmi ekzistencial theksohet funksioni kompensues i dëmit duke mohuar në këtë mënyrë funksionin ndëshkues i cili nuk pranohet nga e drejta. Referuar këtij vendimi, kërkuesi nuk mund t’i drejtohet formulave standarde të shpërblimit, duke theksuar se dëmi ekzistencial është një pasojë automatike e faktit të paligjshëm. Është domosdoshmërisht e nevojshme të provohet gjithçka që ka ndikuar konkretisht për çekuilibrimin e mënyrës së jetesës: *në qoftë se nuk ka dëmtim, asgjë nuk mund të shpërblehet.*

5. Dëmi ekzistencial dhe dëmi moral

Dëmi ekzistencial ka ngjallur debate të mprehta nëse është një figurë e posaçme dëmi apo në të vërtetë është i integruar në figurën e dëmit moral. Nuk janë të paktë autorët dhe juristët që mbajnë qëndrimin se krijimi i figurës së dëmit ekzistencial është i tepërt. Në të vërtetë, nuk është se mungon vullneti i këtyre doktrinarëve për të njohur dëmin ekzistencial, por faktikisht, sipas tyre dëmi ekzistencial nuk ekziston.¹³

5.1 Disa arsye që tregojnë mungesën e dëmit ekzistencial

5.1.1 Dëmi ekzistencial nuk cënon të drejta të reja

Duke qenë se dëmi ekzistencial është pranuar të jetë çdo dëmtim që shkakton ndryshime tronditëse në mënyrën e të jetuarit të të dëmtuarit duke ja shmangur mundësitë për të shfaqur personalitetin e tij në marrëdhëniet shoqërore ose “në botën e jashtme”, duke e detyruar atë të bëjë zgjedhje që kanë të bëjnë me jetën e tij, të ndryshme nga ato që do të bënte në qoftë se nuk do të shkaktohej dëmi, mbështetësit e dëmit ekzistencial duhet të pranojnë që jo çdo “*humbje ekzistenciale*” mund të shkaktojë një dëmtim që duhet të zhdëmtohet. Pra, ata duhet të përcaktojnë një kriter përzgjedhës, në bazë të të cilit të kualifikohen *humbjet ekzistenciale* që meritojnë të dëmshpërblehen, sepse jo të gjitha mund të jenë objekt dëmshpërblimi. Në këtë rast, është e lehtë për t’u evidentuar që *humbjet ekzistenciale* që meritojnë të dëmshpërblehen janë ato të lidhura me parimet kushtetuese dhe ligjore. Por nga sa u tha më sipër, humbet veçoria, risia e sjellë nëpërmjet konceptit të dëmit ekzistencial. Nuk është e nevojshme të shfaqet një figurë e posaçme

¹² Vendimi Unifikues.

¹³ Giulio Ponzanelli, *Danno e Responsabilita*, faqe 696.

dëmi jopasuror, siç është dëmi ekzistencial, për të mundësuar dëmshpërblimin e dëmtimeve si rezultat i zhdëmtimit të të drejtave kushtetuese dhe ligjore. Dëmi ekzistencial nuk shkakton dhunimin e një të “drejte të re”, prandaj nuk mund të jetë një zë i ri në kategorinë e dëmit. Dëmi mund të jetë ose biologjik ose moral.¹⁴

5.1.2 Dëmi ekzistencial prodhon pasoja të dyfishta

Dëmi moral shkakton një dhimbje dhe vuajtje shpirtërore të brendshme, me karakter subjektiv. Por, dallimi midis dëmit moral dhe dëmit ekzistencial nuk mund të bazohet në atë që “*dëmi moral shkakton vuajtje, ndërsa dëmi ekzistencial e privon të dëmtuarin nga kryerja e veprimtarive të caktuara, të cilat do t’i bënte në qoftë se nuk do t’i shkaktohej ky lloj dëmi*”. Ndërkohë, që vuajtja e shkaktuar nga dëmi moral nuk është gjë tjetër veçse pasojë që vjen nga privimi, pamundësia për të kryer veprime të caktuara. Dhimbja e shkaktuar nga humbja e një të afërmi të dashur, dëmtimi i shëndetit, humbja e reputacionit etj, padyshim që shkakton që i dëmtuari të heqë dorë nga veprimtari të shumëllojshme (p.sh të shkojë në kinema, të dalë shëtitje etj). Por, në këtë rast pasoja të tilla janë vlerësuar të dëmshpërblehen për shkak të dëmit moral. Në qoftë se do të pranohej edhe dëmi ekzistencial, do të prodhohej një dëmshpërblim i dyfishtë. Kështu që arrihet në përfundimin që dëmi ekzistencial në të vërtetë është dëm moral.

Pavarësisht mbështetësve të tezës për mungesën e dëmit ekzistencial jemi të mendimit që dëmi ekzistencial përbën një figure të pavarur në kategorinë e dëmit jopasuror duke zmadhuar përmasat e këtij lloj dëmi. Nuk mund të pranohet që dëmi ekzistencial s’është gjë tjetër veçse dëm moral. Ka dallime të dukshme midis tyre.

Në vendimin unifikues Gjykata e Lartë ka dhënë kuptimin e dëmit moral. Sipas vendimit “*Dëmi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm*.”.

Nga kuptimi i dëmit moral dhënë prej këtij vendimi evidentohen tre elementë karakterizues të këtij lloj dëmi:

a) Pasoja

Pasoja të dëmit moral janë shfaqja e brendshme e turbullimit të padrejtë, dhimbja apo vuajtja shpirtërore, gjendje ankthi, mundim shpirtëror që ka derivuar për shkak të faktit të paligjshëm.

¹⁴ Giulio Ponzanelli, Danno e Responsabilita, faqe 700.

b) Kohëzgjatja e pasojës

Sipas vendimit “Dëmi moral (*pretium doloris ose pecunia doloris*) është shfaqje e brendshme, e **përkohshme**,...” Pra, në rastin e dëmit moral dhimbja dhe vuajtja shpirtërore janë gjendje të përkohshme prej të cilave i dëmtuari rehabilitohet brenda një periudhe të caktuar në varësi të ngjarjes dëmshkaktuese dhe ndjeshmërisë personale të çdo subjekti.

c) Barra e Provës për vërtetimin e dëmit

Siç e shpjeguar më sipër, në rastin e dëmit ekzistencial, i dëmtuari duhet të provojë me prova konkrete shkaktimin e dëmit. Ndërsa, në rastin e dëmit moral, pasoja prezumohet. Në vendimin unifikues Gj. Lartë është shprehur se “... *nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, etj., nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar ius receptum si të mbështetura ligjërisht dhe duke i çmuar si të provuara ipso iure me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cënimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore. Duke qenë provë në formën e prezumimit të thjeshtë, nëse shkaktuesi i dëmit nuk arrin të vërtetojë të kundërtën, ajo merr të njëjtën vlerë e fuqi të plotë provuese sikurse prezumimi ligjor iuris tantum (neni 13 i K.Pr.Civile).”*

Dëmi moral shkakton një *gjendje të përkohshme* ankthi e turbullimi shpirtëror, ndërkohë që dëmi ekzistencial sjell *pasoja të përhershme, të pariparueshme* që shprehen në shfaqjen e personalitetit të të dëmtuarit në botën e jashtme duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve te jetës, të marrëdhënieve personale e familjare.

6. Padia për shpërblimin e dëmit jopasuror**6.1 Kompetenca tokësore**

Padia për shpërblimin e dëmit jopasuror mund të ngrihet prej cilitdo që pretendon shkaktimin e këtij lloji dëmi. Në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente nga ana territoriale, duhet t’i referohemi KPrC. Si rregull, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri. Në nenin 42/1 të KPrC parashikohet që “*Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme.*” Ndërsa, në rastin kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku ka qendrën e tij. (neni 43/1). Për paditë e shpërblimit të dëmit KPrC ka parashikuar një kompetencë alternative ose konkurruese. Konkretisht, në nenin 48 parashikohet që “*Paditë që*

rrjedhin nga shkaktimi i dëmit mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ka banimin i padituri, ashtu dhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi.” Pra, kjo dispozitë i referohet padive që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit, duke përfshirë dëmin pasuror dhe jopasuror. Në këtë rast, KPrC ia ka lënë në dorë paditësit të zgjedhë gjykatën kompetente për gjykimin e padisë. Në çështjen I.I. kundër shoqërisë “Botimet Periodike Spektër” sh.a., gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pala e paditur pretendoi se gjykatë kompetente për shqyrtimin e padisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, meqenëse selia e shoqërisë së paditur gjendej në Tiranë. Kjo kërkesë nuk u pranua nga gjykata duke argumentuar se:

“ Sipas shpjegimeve të palës paditëse dhe nga çertifikata e lindjes së saj, rezulton se vendbanimi i saj është në Patos Qarku Fier dhe pala paditëse pretendon se ky dëm i është shkaktuar në Fier, duke qenë se është vendbanimi i saj dhe këtu ndodhen të afërmit dhe miqtë që e njohin. Gjatë analizimit të kësaj çështje civile Gjykata ka parasysh përcaktimet e nenit 54 të K.Pr.C sipas të cilit: “E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë.”

Nga sa më sipër, referuar faktit se në rastin konkret për këtë lloj padie që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, janë parashikuar nga ligji dy gjykata kompetente dhe se paditësi e ka ushtruar të drejtën e zgjedhjes së tij nëpërmjet ngritjes së kërkesë padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykata vlerëson se ajo ka kompetencë tokësore për gjykimin e kësaj çështje, si gjykatë e vendit ku pretendohet se është shkaktuar dëmi.”¹⁵

6.2 Karakteri i parashkrueshëm ose jo i padisë për shpërblimin e dëmit jopasuror

Në nenin 113 të K.Civil parashikohet që:

“Nuk parashkruhen: a) padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj.”

Ndërsa, në nenin 115/dh parashikohet që:

“ Parashkruhen brenda tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.”

Nga përballja e këtyre dy dispozitave, në pamje të parë duket sikur është e paqartë nëse padia për shpërblimin e dëmit jopasuror ka karakter të parashkrueshëm apo jo. Por, realisht kjo padi ka karakter të parashkrueshëm sepse nëpërmjet saj nuk kërkohet mbrojtja e një drejte vetjake jopasurore, por shpërblimi i demit që përveç te tjerash mund te ketë ardhur edhe nga cenimi i një te drejte vetjake jopasurore.

Afati i parashkrimit fillon nga dita që i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.” (neni 120 i K.C)

7. Konkluzion

¹⁵ Vendimi nr. 291 dt. 20.02.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Tashmë, hapi pozitiv është hedhur. Gjykata e ka pranuar qenien e dëmit ekzistencial si figurë të pavarur në kategorinë e dëmit jopasuror. Për të përcaktuar dëmin ekzistencial nuk ka një njësi matëse për të vlerësuar se sa është humbja e pësuar në këtë rast si dhe vuajtjet që pësojnë personat e dëmtuar. Prandaj, është e nevojshme që gjykata të mbështetet në disa kriterë orientues mbi bazën e të cilëve të përcaktojë shpërblimin e dëmit rast pas rasti. Doktrina dhe praktika gjyqësore ka evidentuar kriterë të tillë, disa prej të cilëve janë edhe shumë të debatuar. Por, dimensionin “*njerëzor*” i dëmit nuk mund të lihet pas dore dhe të konsiderohet si i shpërblyeshëm, i zhdëmtueshëm në mënyrë të përshtatshme. Çdo mbartës i dëmit e përjeton atë ndryshe. Të mohohet ky fakt do të thotë të mohohet vetë kuptimi i dëmit ekzistencial, një koncept që i referohet *njeriut dhe vuajtjes së tij*, që është një vuajtje individuale, specifike, subjektive dhe mbi të gjitha nuk mund të mohohet që çdonjëri është unik, *i ngjashëm vetëm me vetveten*.

Bibliografia

Ligje:

Kodi Civil i RSH i vitit 1994 ;

Kodi i Procedurës Civile.

Literatura Juridike Shqiptare:

Mariana Semini (Tutulani) “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” (pjesa e përgjithshme), Botimi i tretë, Tiranë 2002

Luan Omari “Parime dhe institucione të së drejtës publike” Shtëpia botuese Elena GJIKA, Tiranë 1999,

Prof. Dr. Ismet Elezi, Prof.As.Dr. Skënder KAÇUPI, Dr. Maksim HAXHIA, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2001.

Literatura Juridike e huaj:

Lima F. “Il danno esistenziale”, 07.02.2007, brochure;

Giulio Ponzanelli, Danno e Responsabilita.

Praktika gjyqësore shqiptare:

Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në RSH, nr. 12, 13.09.2007, 14.09.2007;

Vendimi nr. 291, dt. 20.02.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Praktika gjyqësore e huaj:

Vendimi nr. 6572, dt. 24.03.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit Italiane;

Vendimi nr. 2677, dt. 11.03.1998 i Gjykatës së Kasacionit Italiane;

Vendimi nr.7713 i vitit 2000 i Gjykatës së Kasacionit Italiane

Vendimi dt. 14.02.2003 i Gjykatës së Apelit Milano, Seksioni 2 Civil.

Burime nga Interneti:

www.euroaustici.org

www.ambientediritto.it/giurisprudenza/it

www.personaedanno.it

www.diritto.it/articoli/civilesechi

www.lexitalia.it

www.gjykataelarte.gov.al